

**KONTRATA E PAJTIMIT
PER SHERBIMET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
NE RRJETIN FIKS TE OPERATORIT NET.COM SHPK**

Lidhet sot me date ___/___/202___, ndermjet paleve:

Net.Com shpk, me NIPT: M41422504S, me seli ne adresen: Rruga Josif Budo, Pasuria nr. 4/322, Zona Kadastrale 8552, Kavaje, i autorizuar nga AKEP për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh te komunikimeve elektronike (i cili më poshtë do të quhet Operatori),

Dhe

Pajtimtarit: _____

Familjar Biznes Tjetër (_____)

me të dhenat identifikuese sipas formularit të regjistrimit të AKEP, bashkëlidhur kësaj kontrate.

SEKSIONI 1. SHERBIMET

INTERNET

Mënyra e lidhjes:

Me Fiber Optike

SEKSIONI 2: AUTORIZIME

- Per marrjen ne perdorim, perpunimin, transferimin ose ruajtjen dhe asgjesimin fizik, te te dhenave personale te deklaruar ne kete Kontrate Pajtimi, ne përputhje me ligjin ne fuqi per mbrojtjen e te dhënave personale:

Pranoj Nuk Pranoj

SEKSIONI 4: FATURA E SHERBIMIT DHE ADRESA E DERGIMIT TE FATURES:

Adresa e dergimit te fatures/ njoftimeve me shkrim:

Adresa email: _____ Numer kontakti _____

Fature elektronike PO JO

Shenim: Pajisja me fature elektronike automatikisht zevendeson pajisjen me fature fizike.

Ne cilesine e Pajtimtarit, deklaroj se:

- Jam njohur me Informacionin Para-Kontraktor te vendosur ne dispozicion nga Operatori dhe me kontraten e plote ne faqen e internetit të Operatorit;

- Jam njohur dhe pranoj kushtet dhe termat e Kontates se Pajtimimit, si dhe deklaroj se do t'i zbattoj ato perkatesisht, perfshire por pa u kufizuar ne: Sherbimet e kontraktuara, afatin e kontrates dhe perfundimin e saj, cmimin dhe tarifate, menyren dhe afatet e pageses, dhe/ ose garancive financiare;
- Te dhenat e plotesuara ne Kontraten e Pajtimimit dhe Formularin e AKEP jane te sakta dhe i perkasin personit/subjektit tim, referuar mjetit te identifikimit te paraqitur personalisht prej meje;
- Deklaroj se qellimi i blerjes se sherbimit eshte per perdorimin e sherbimit sipas kategorise Familjar/Biznes dhe ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate dhe ne asnje rast per rishitje apo perdorim per qellime fitimi apo ne kundershtrim me ligjin. Deklaroj qe te dhenat e mesiperme jane te verteta;
- Numri i kontaktit (celular) dhe adresa elektronike jane te sakta dhe do te perdoren per njoftime zyrtare per kete kontrate si dhe per autentifikime apo sherbime te tjera ne kuader te kesaj kontrate;
- Mora dijeni te plote dhe pranoj te gjitha kushtet e mesiperme.

Kontrata e Pajtimimit perbehet nga:

Lidhja 1: Termat dhe kushtet e pergjithshme te ofrimit te sherbimit
 Aneksi 1: Lista e shpejtesise se lidhjes ne internet, tarifave standarte dhe Udhezuesi per Zgjidhjen e Ankesave dhe formulari i regjistrimit i miratuar nga AKEP.

Lidhjet e kontrates se bashku me anekset respektive dhe formulari i AKEP jane pjese integrale dhe e pandashme e saj.

Termat dhe kushtet e pergjithshme te ofrimit te sherbimit, Informacioni Para-Kontraktor dhe tarifate standarte jane te publikuara ne faqen zyrtare te internetit te Operatorit www.netcom.al.

Kontrata e Pajtimimit hartohet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) origjinale te njevlershem ne gjuhen shqipe, nje per Operatorin dhe nje per Pajtimtarin.

Kjo kontrate lidhet me afat ____ muaj, ose deri ne datën _____.

Per Operatorin

Pajtimtari

LIDHJA 1

TERMAT DHE KUSHTET E PERGJITHSHME TE OFRIMIT TE SHERBIMIT

NENI 1 OBJEKTI KONTRATES

Ofrimi i sherbimit te aksesit ne internet nga Operatori, nepermjet rrjetit te tij te komunikimeve elektronike me specififikimet e dhena ne Lidhjen 1 dhe Aneksin 1, sipas kerkeses se pajtimtarit.

NENI 2 TARIFAT

2.1 Tarifat standarde, te ofruara nga Operatori dhe te pranuar nga Pajtimtari, paraqiten ne Aneksin 1 te kesaj Lidhje dhe jane pjese integrale e Kontrates se nenshkruar midis paleve.

2.2 Plani tarifor i perzgjedhur nga Pajtimtari paraqitet ne Aneksin 1 te Kontrates se Pajtimtit.

2.3 Tarifat e Sherbimeve jane objekt ndryshimi, te cilat vendosen dhe publikohen sipas kerkesave te ligjit Nr. 54/2024 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise".

NENI 3 KOHEZGJATJA

3.1 Kjo kontrate lidhet per nje afat minimal te pakten prej ____ muajsh ose deri ne daten _____. Ne cdo rast, afati minimal i produktit te kontraktuar, parashikohet ne Aneksin 1, Plani Tarifor".

3.2 Ne rast perfundimi te kesaj kontrate nga Pajtimtari perpara perfundimit te afatit minimal, ky i fundit detyrohet te paguaje penalitet per perfundim te kontrates para afatit. Penaliteti do te jete proporcional dhe perfshin pagimin e vleres se plote te pajtimtit mujor per pjesen e mbetur te afatit te kontrates.

3.3 Operatori do te njoftoje Pajtimtarin nepermjet sherbimit postar/ e-mail/ SMS/ apo formave te tjera te komunikimeve elektronike te qendrushme, 30 dite perpara perfundimit te afatit minimal te kontrates.

3.4 Ne rast se Pajtimtari, nuk shprehet me shkrim per perfundimin e kontrates brenda afatit 30 ditor te njoftimit per perfundimin e afatit minimal te kontrates, palet bien dakord se kontrata, kalon ne nje kontrate me afat te pacaktuar. Gjate afatit te pacaktuar, Pajtimtari do tarifohet sipas planit tarifor baze ne Aneksin 1.

NENI 4 DETYRIMET

4.1 OPERATORI DETYROHET:

4.1.1 Te mundesoje per pajtimtarin sherbim konform standarteve te parashikuara ne kete Lidhje dhe anekset e saj. Pavaresisht kesaj, cilesia e sherbimit te ofruar nga Operatori mund te ndikohet nga faktore te tjere, te cilet jane jashte kontrollit te Operatorit, duke perfshire por mos u kufizuar me zonen e mbulimit, distancen, teknologjine e ofrimit te sherbimit, pajisjet fundore, kushtet atmosferike etj., qe mund te ndikojne ne parametrat e sherbimit te ofruar.

4.1.2 Te aktivizoje ofrimin e Sherbimit, brenda 3 diteve pune nga nenshkrimi i Kontrates se Pajtimtit. Ne kete afat perjashtohen vonesat e krijuara nga Pajtimtari.

4.1.3 Te ofroje sherbime te komunikimeve elektronike ne perputhje me parimin e transparences, proporcionalitetit dhe barazise sipas kushteve dhe çmimeve, sipas llojit te teknologjise se perdorur, kategorise se pajtimtareve, volumit te trafikut dhe metodeve se pageses.

4.1.4 Te evidentoje ankesat dhe shqetesimet e Pajtimtarit dhe ta informoje ate per zgjidhjen e mundshme te tyre brenda afateve te percaktuara ne kete Lidhje dhe Aneksin 1.

4.1.5 Te riparoje defektet teknike dhe te rivendose ofrimin e sherbimit perkatesisht sipas afateve te percaktuara ne kete Lidhje dhe Aneksin e saj. Ne cdo rast, keto afate do te llogariten nga momenti i njoftimit ne numrat e informacionit te Operatorit.

4.1.6 Te riaktivizoje sherbimin brenda 24 (njezetekater) oreve, nga momenti qe Pajtimtari ka shlyer te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, por ne cdo rast me kusht qe pagesa te jete kryer perpara perfundimit te kontrates.

4.1.7 Te njoftoje nepermjet medias dhe afishimeve, prane njesise ankimore e zyrave te tij, çdo ndryshim te tarifave te Sherbimeve, jo me vone se 7 dite kalendarike, jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, perpara zbatimit te tyre.

4.1.8 Pas kerkeses nga pajtimtari me shkrim apo nepermjet aplikimeve online, nese keto te fundit ofrohen nga operatori, te kryeje ndryshimin e paketes se sherbimit ose shpejtesise se transmetimit per sherbimin e aksesit ne internet.

4.1.9 Operatori nuk mban pergjegjesi per problemet/ defektet apo demet direkte ose indirekte qe mund te vijne si pasoje e perdorimit te Internetit ne menyre te pavarur nga Pajtimtari si p.sh. hapjes se faqeve te ndryshme te Internetit, shkarkimit te programeve nga Interneti, demtimi nga viruset, aplikimi i formave te pagesave online etj.

4.1.10 Te njoftoje Pajtimtarin per modifikime te Kontrates jo me vone se 30 dite perpara dates se hyrjes ne fuqi te ketyre modifikimeve.

4.1.11 T'i jape Pajtimtarit nje shpjegim te hollesishem te te gjitha kushteve te perdorimit dhe kontrates para nenshkrimt te kontrates, nepermjet Informacionit Para-Kontraktor, te publikuara ne faqen zyrtare te internetit te Operatorit.

4.1.12 Ky Informacion Para-Kontraktor perfshin por nuk kufizohet ne nje informacion te detajuar per planet tarifore qe mund te zgjedhe Pajtimtari, duke i dhene mundesine e krahasimit midis tyre, perfshire:

i. Informacion te plote dhe te qarte, per paketat tarifore dhe ofertat promocionale apo speciale si zbritjet e tarifave, trafik i pakufizuar apo perdorim i pakufizuar i Internetit, kohen e kryerjes se thirrjeve apo perdorimit te internetit, duke specifikuuar midis te tjerave çfare perfshihet ne pakete/oferte dhe çfare nuk perfshihet ne to, afatet kohore te ofertave dhe efektet e tejkalimit te tyre, perfshire tarifat e aplikuar.

ii. Sistemin tarifor te aplikuar per sherbimet si kufizime te perdorimit, koha e tarifimit, menyra e tarifimit pas kalimit te kohes minimale ose tejkalimit te kufizimit, njesia e matjes per tarifimin (p.sh. MByte etj.), ndryshimi i tarifes me kohezgjatjen, etj.

iii. Sherbimet shtese te perfshira ne paketen e zgjedhur.

iv. Informacion per cilesine e sherbimeve te ofruara/zgjedhura perfshire informacion dhe sqarime per shpejtesine e Internetit.

4.1.13 Te mos refuzoje lidhjen ne rrjet te pajisjeve fundore qe jane ne perputhje me Ligjin Nr. 54/2024 dhe akteve nenligjore te tij.

4.1.14 Operatori mund te ofroje pajisje fundore per pajtimtarin.

4.1.15 Termat dhe kushtet e rena dakort ne lidhje me pajisjet fundore, çmimi i pajisjes fundore dhe rimbursimi i kostove te pajisjeve ne rast perfundimi te kontratës (nëse aplikohen), do te paraqiten ne nje aneks te vecante te kontrates se pajtimit.

4.1.16. Te aplikojte rritjen e tarifes se nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, vetem pas ezaurimit te procesit te njoftimit te pajtimtarit nga Operatori ne nje nga format e meposhtme:

- Nepermjet njoftimit individual me poste/e-mail/SMS, apo forma te tjera te komunikimeve elektronike te qendrueshme, te pakten 30 (tridhjetete) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre, ne rastin kur rritja e tarifave aplikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet te perfshije adresen se ku jane publikuar rritjet e tarifave, ne rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve.

4.1.17 Te aplikojte automatikisht edhe pa njoftim uljen e tarifes te nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, brenda paketes se zgjedhur ne Aneks dhe permiresimin e treguesve te cilesise se sherbimeve te kontraktuara nga Pajtimtari.

4.1.18 Te mos vendose detyrim financiar per rilidhje ne rrjet, nese nderpreja e sherbimit eshte kryer per shkak te gabimeve te Operatorit.

4.1.19. Per paketat tarifore, qe kane tarifim te pershkallezuar, per perdorim te sherbimit “download” dhe/ose “upload”, deri ne nje nivel te caktuar limit (kufizim), dhe mbipagese per perdorim mbi kufizimin (tarife per Mbyte), Operatori ka detyrimin te kryeje njoftimin e pajtimtarit nepermjet mjeteve elektronike (si p.sh. mesazh ne PC, etj) jo me pak se 3 (tre) dite rresht kur arrihet niveli 80% i kufizimit “download”/“upload” (nese ka te tille).

4.1.20 Operatori ka detyrim qe ne faqen kryesore te website zyrtar te tij te ofroje nje instrument matje te shpejtesise te aksesit ne Internet per pajtimtarin. Matesi i shpejtesise ofron mundesine per te matur te pakten:

a.download speed (shpejtesine e shkarkimit) ne Mbps ose Kbps;

b.upload speed (shpejtesine e ngarkimit) ne Mbps ose Kbps

c. latency (vonesen e lidhjes) ne milisekonda;

4.1.21 Shpejtesia e sherbimit te aksesit ne internet, per arsye teknologjike i ofrohet Pajtimtarit deri ne shpejtesine qe i korrespondon shpejtesise se perzgjedhur nga Pajtimtari ne planin tarifor perkates dhe Operatori do te beje perpjekjet maksimale ne lidhje me kete.

4.1.22 Operatori do te marre dhe zbatoje masa teknike dhe organizative per te siguruar rrjetin, sherbimin, konfidencialitetin e komunikimit dhe te dhenat e trafikut te komunikimit sipas parashikimeve te ligjit nr. 54/2024.

4.1.23 Operatori mund te ndermarre masa te arsyeshme per menaxhimin e trafikut per te evituar rreziqe nga mbingarkesa te rrjetit apo sigurimin e parametrave te cilesise se sherbimit, masa te cilat nuk do te zbatohen per nje kohe me te gjate se sa eshte e nevojshme.

4.1.24 Te lajmeroje pajtimtarin nepermjet sherbimit postar/e-mail/SMS/apo formave te tjera te komunikimeve elektronike te qendrueshme ne faqet e tyre apo ne pikat e shitjes:

- Per nderprerjet dhe cilesine e dobet te sherbimit te ofruar, gjate kontroleve periodike, riparimeve apo permiresimeve te rrjetit, provave te planifikuara si edhe ditën dhe kohezgjatjen e nderprerjes apo cilesine e dobet te sherbimit jo me vone se 24 ore perpara perfundimit te tij efektiv.

- Per kufizimet ne ofrimin e sherbimeve te imponuara nga autoritetet kompetente ne kushte te jashtezakonshme, fatkeqsive apo avarive te lidhura me mbrojtjen dhe sigurine kombetare, pa ja hequr pergjegjesine per normalizimin e gjendjes brenda nje periudhe sa me shkurter te jete e mundur.

4.1.25 Operatori mund te ndermarre masa deri ne pezullimin e sherbimeve si kunderveprim ndaj incidenteve te sigurise ose integritetit apo per shkak te kercentimeve dhe cenimeve ndaj rrjetit/sherbimit.

4.1.26 Te siguroje kushte per pranimin e pagesave nga Pajtimtarit, per gjate gjithë diteve te javes, me orar 08⁰⁰–20⁰⁰.

4.1.27 Te trajtojte dhe te zgjidhte brenda 3 (tre) diteve kalendarike, kerkesen e Pajtimtarit per cdo ndryshim te sherbimeve shtese dhe te kategorise se pajtimit.

4.1.28 Te njoftojte me shkrim/sms/etj, per zbatimin e sanksioneve sipas parashikimeve te kesaj kontrate ne rast mospermbushje te detyrimeve kontraktore nga Pajtimtari.

4.1.29 Te trajtojte kerkesat/ankesat me shkrim te Pajtimtarit.

4.1.30 Te publikojte treguesit e cilesise per sherbimin internet.

4.1.31 Te zbatoje, per zgjidhjen e mosmarreshjeve me Pajtimtarin, procedura te thjeshta dhe efektive.

4.1.32 Te riaktivizojte automatikisht sherbimin e pezulluar nga pajtimtari, sipas kerkeses se ketij te fundit, menjehere pas perfundimit te afatit te pezullimit te sherbimit te percaktuar ne kerkesen.

4.1.33 Te rimbursojte pajtimtarin per mbifaturime per sherbimet e ofruara.

4.1.34 Te mundesojte akses te barabarte dhe mundesi zgjedhjeje per pajtimtaret me aftesi te kufizuara, sipas percaktimeve ligjore dhe akteve nenligjore ne fuqi, ne lidhje me kete.

- 4.1.35 Te mundesoje per pajtimtarin ne menyre te thjeshte dhe pa pagese ndalimin automatikisht te thirrjeve te ridrejtuar nga nje pale e trete ne drejtim te pajisjes fundore te pajtimtarit.
- 4.1.36 Te kryeje monitorim te vazhdueshem te sherbimeve dhe te marre masa per riparimin e problemeve teknike ne kohen me te shkurter qe te jete e mundur por jo me shume se 72 ore. Afati i riparimit fillon nga momenti i njoftimit te problemit nga pajtimtari apo nga konstatimi i tij nga Operatori, perjashtuar rastet kur vonesa vjen nga Pajtimtari.
- 4.1.37 Operatori duhet te ruaje informacionin sipas kushteve te vendosura ne ligj dhe duhet te behet i vlefshem per pajtimtare me kerkesen e tyre me shkrim, sic percaktohet nga ligji.
- 4.1.38 Operatori merr persiper realizimin e aktivizimit te sherbimit te kontraktuar dhe riparimin e difekteve apo zgjidhjen e ankeses se pajtimtarit brenda 3 diteve pune nga data e nenshkrimit te kontrates apo nga data e konstatimit te defektit ose paraqitjes se ankeses nga pajtimtari. Per ankesa specifike ne lidhje me faturimin, koha e zgjidhjes mund te jete me e gjate se 3 dite, por ne te gjitha rastet jo me vone se data e daljes se fatures se muajit pasardhes per te cilin pajtimtari ka bere ankesen.
- 4.1.39 Te vendos ne dispozicion te personave me aftesi te kufizuar versionin ne "large print" ose "braille" te kontrates se pajtimtit. Detajet te kontaktit te sipermarresit per kete qellim publikohen ne faqen zyrtare te internetit te Operatorit.

4.2 PAJTIMTARI DETYROHET:

- 4.2.1 Te siguroje me shpenzimet e tij instalimin e sherbimeve dhe/ose pajisjen e nevojshme per lidhjen e sherbimit te internetit (Modem/Spliter/Ruter/etj). Ne rastet kur pajisjet ofrohen nga Operatori, pajtimtari eshte i detyruar ti ktheje ato, ne gjendje pune, ne përfundim te kontratës, ose te kompensoje ne vlere monetare pajisjet, duke zbritur koston e amortizimit.
- 4.2.2 Te kryeje pagesen per sherbimin e ofruar, sipas menyres dhe afateve te percaktuara ne Kontrate dhe Lidhjet/ anekset e saj si dhe te marre dhe ruaje kopjen e dokumentave qe vertetojne kryerjen e veprimeve financiare per pagesen e fatures.
- 4.2 Te likujdoje te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, qe kane lindur deri ne momentin e perfundimit te kontrates.
- 4.2.1 Te perdore sherbimin e ofruar ne perputhje me kategorine e pajtimtit te percaktuar ne Kontrate.
- 4.2.2 Te mos perdore sherbimin e ofruar per qellime ilegale, per te shqetesuar, fyer apo kercenuar Pajtimtare e rrjeteve te tjera te komunikimeve elektronike, apo per te kryer vepra qe bien ne kundershkrim me Legjislacionin Shqiptar.
- 4.2.3 Te mos keqperdore sherbimin dhe te mos vendose ne rrezik sigurine dhe integritetin e rrjetit te Operatorit.
- 4.2.4 Te mos perdore sherbimin per qellime rishitje.
- 4.2.5 Te mos transferoje sherbimin ne palet e treta.
- 4.2.6 Te mos ofroje ne çdo forme, per nje arsye apo nje tjetër, as te krijojë kushte per kopjim, regjistrim, ritransferim ose perdorim te permbajtjes dhe sherbimeve per qellime te tjera, dhe pa kapercim ose perpjekje te kaperceje mekanizmat per mbrojtjen e programeve kunder veprimeve te tilla dhe/ose perdorime te paautorizuara.
- 4.2.7 Te lidhe ne rrjet vetem pajisje te certifikuar dhe te sigurohet qe teknologjia e tyre eshte e pershtatshme me ate qe kerkohet ne sherbimin e aksesit ne internet te Operatorit.
- 4.2.8 Te mos zbatoje, apo lejoje persona te paautorizuar, te bejne ndryshime ne pajisjet e komunikimeve elektronike dhe/ose rrjetit dhe te mos lejoje keta te fundit te lidhen te pajisjet e tyre pa njoftimin me shkrim me pare te operatorit.
- 4.2.9 Te mos demtoje instalimet apo pajisjet telefonike, por pa u kufizuar vetem ne to, te Operatorit, te cilat ndodhen ne territorin dhe objektet prone private ose publike.
- 4.2.10 Te lejoje ne rast nevojë, per realizimin e ofrimit te sherbimit te pajtimtarit, hyrjen ne pronat private, te punonjesve te autorizuar te Operatorit, per përmbushjen e kontrates.
- 4.2.11 Te mos kaloje apo transferoje te te tretet te drejtat dhe detyrimet ndaj Operatorit sipas kontrates se pajtimtit, pa miratimin me shkrim te ketij te fundit.
- 4.2.12 Te njoftoje me shkrim Operatorin, per cdo ndryshim te te dhenave te tij identifikuese, apo te dhenave te komunikimit mes paleve. Deri ne njoftimin e ndryshimeve te tilla, faturat dhe cdo komunikim/njoftim tjetër do te vijojë kryhet ne pikat e kontaktit te percaktuara ne kontrate.
- 4.2.13 Te mos lejoje akses per te miturit ne programe pornografike ose programe te tjera dhe ose ne adresa interneti te papershtatshme.
- 4.2.14 Te mbroje dhe te menaxhoje me kujdesin e tij pjeset e perbashketa te rrjetit te komunikimeve elektronike te operatorit te ndertuara ne pronen e pajtimtarit dhe/ose pronen ne perdorim. Pajtimtari nuk do t'u lejoje akses paleve te treta ne keto pjese te rrjetit, perveç se me miratimin e operatorit.
- 4.2.15 Te ndihmoje operatorin ne ndertimin e pjeseve te perbashketa dhe te aferta te rrjetit, duke perfshire kanalet e lidhjeve te rrjetit te godines per rrjetin e komunikimeve elektronike publike te Operatorit dhe instalimin e rrjetit te komunikimeve te godines.
- 4.2.16 Te paguaje per demet e shkaktuara me dashje (paramendim) per Operatorin qe jane direkte (te drejtperdrejta), te menjehershme me veprimet e tyre dhe prishin detyrimet sipas kesaj kontrate. Pajtimtari mund te deshtojë ne plotesimin e ndonje detyrimi te parashikuar ne kete kontrate, ne rastin e nje force madhore. Ne keto raste, ai do te njoftohet ne kohe nga Operatori per natyren, forcen madhore dhe pasojat e mundshme, per plotesimin e detyrimeve te tyre.
- 4.2.17 Te ktheje aparatit apo pajisjen e komunikimeve elektronike te marre ne perdorim ne kushtet qe i jane dhene, perveçse per perdorim funksional normal, brenda 5 (pese) diteve kalendarike, ne rastet e perfundimit te kontrates nga Operatori. Ne rastin e perfundimit te kontrates nga ana e Pajtimtarit, Operatorit i lind e drejta te kerkoje kthimin e aparatit apo pajisjeve te komunikimeve elektronike ne perdorim ne momentin e paraqitjes se kerkeses per perfundim Kontrate.

4.2.18 Te paguaje te gjitha detyrimet e papaguara, duke perfshire faturat e papaguara, faturen e emetuar nga Operatori deri ne ditën e ndërprerjes se kontrates.

NENI 5. TE DREJTAT

5.1 OPERATORI KA TE DREJTE:

5.1.1 T'i nderprese ofrimin e Sherbimit dhe ose sherbimeve, pajtimtarit i cili nuk ka zbatuar detyrimet qe rrjedhin nga percaktimet e Nenit 4.2.

5.1.2 Te nderprese sherbimin objekt kontrate ne menyre te njeanshme, duke njoftuar te pakten 24 ore me perpara, per qellime mirembajtje dhe permiresimin e sherbimit. Kohezgjatja e nderprerjes te jete jo me shume se 48 ore.

5.1.3 Te ndryshoje tarifat e ofrimit te Sherbimit gjate vlefshmerise se kontrates, sipas kushteve te percaktuara ne piken 4.1.

5.1.4 Te beje ndryshime e permiresime ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve sipas nevojave te zgjerimit te rrjetit dhe te teknologjise.

5.1.7 Te mos pezulloje sherbimet, pavaresisht kerkeses se pajtimtarit, kur sherbimet ofrohen se bashku ose jane ngushtesisht te lidhur me njeri-tjetrin. Operatori ne cdo rast, mund te vendose ne diskrecion te tij ndryshe.

5.10 Te aplikojte dhe zbatojte kerkesat e pajtimtarit te paraqitur nga ky i fundit me shkrim apo nepermjet aplikimeve online, sipas kushteve te kesaj kontrate dhe anekseve te saj.

5.1.11 Te refuzojte te ekzekutoje nje kontrate sherbimesh, per lidhje ne rrjet ose rikthimin e aksesit te rrjetit te pezulluar perkohesisht dhe te ndaloje ofrimin e disa apo gjithe sherbimeve ne raste kur pajtimtari:

- Deshton per te siguruar te dhena dhe dokumente sipas kontrates ose kur kushtet e nevojshme per ofrimin e sherbimeve nuk jane plotesuar, perfshire aksesin dhe perdorimin e energjise elektrike ne pronen apo godinen dhe kushte te tjera te ngjashme.

- Ka kaluar afatet ose ka vonuar detyrimet per pagesen e sherbimit/ve te ofruar nga operatori.

- Ka perdorur apo ka lejuar perdorimin e pajisjeve te komunikimeve elektronike ose sherbimeve elektronike per qellime dhe ne kundershtrim me parashikimet e kontrates dhe legjislacionin ne fuqi.

- Ka hyre apo eshte perpjekur te siguroje akses te sherbimet e Operatorit ne nje menyre te parregullt, te papajtueshme me kontraten e pajtimit dhe rregulloret perkatese per ofrimin e sherbimeve objekt kontrate apo te ndaluar me ligj.

5.1.12 Te mos ofroje sherbimin sipas kontrates se pajtimit, kur pajtimtari ka ndermarre vete apo ka lejuar pale te treta te paautorizuara te marrin persiper instalimin, modifikimin apo riparimin e pajisjeve dhe/ose te rrjetit.

5.1.13 Operatori nuk do te jete i detyruar ndaj pajtimtarit per:

- Demin qe nuk shkaktohet nga veprimet direkte apo indirekte nga Operatori;

- Mosplotesim te detyrimeve te tij per shkak te nje force madhore gjate kohezgjatjes se saj;

- Permbajtjen e informacionit te transmetuar nepermjet rrjetit;

- Nderprerjen dhe/ose cilesine e ulet te sherbimeve te komunikimeve elektronike kur kjo eshte ne kufij te parametrave teknike dhe cilesine e rrjeteve te tjera te komunikimeve elektronike, si dhe demet dhe /ose prishjet ne keto rrjete;

- Nderprerjen dhe/ose cilesine e ulet te sherbimeve te komunikimeve elektronike kur kjo ndodh per mungesen, pezullimin, ose prishjen e parametrave teknike te cilesise te pajisjeve te energjise te godinave dhe/ose banesave;

- Mungesen e ofrimit te sherbimeve ose cilesine e dobet te tyre gjate testimeve qe kryhen nga operatori me qellimin per te inspektuar pajisjet, lidhjet, rrjetet, etj., si edhe testet me qellim permiresimin apo efektshmerine e sherbimit te ofruar, vetem subjekt per pajtimtarin duke e mbajtur kete te fundit te informuar paraprakisht.

5.1.14 Operatori ka te drejte te aplikojte politikat e perdorimit te drejte te sherbimeve dhe/ose produkteve te ofruara per pajtimtarin te cilat ne cdo rast do te jene ne perputhje me rregulloret dhe dispozitat ligjore dhe nenligjore perkatese ne fuqi.

5.2 PAJTIMTARI KA TE DREJTE:

5.2.1 Te perdore sherbimin objekt kontrate ne perputhje me termat e kesaj kontrate.

5.2.2 Te kerkoje apo te kryeje me shkrim apo nepermjet aplikimeve online/aplikacioneve te aplikuar nga Operatori ndryshime te tipit te paketes, shpejtesise se transmetimit apo te adreses (vendodhjes), apo blerje ofertash promovionale/paketash shtese per te cilat palet bien dakort.

5.2.3 Te kerkoje me shkrim perfundimin e kontrates ne menyre te njeanshme, por duke perbushur kushtet e kontrates.

5.2.4 Te percaktojte sherbimet fillestare dhe sherbimet shtese qe do te perdore sipas Aneksit te kontrates.

5.2.5 Te kerkoje rilidhjen e Kontrates se Pajtimit, pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve te prapambetura.

5.2.6 Te pezulloje perdorimin e sherbimeve pas paraqitjes se kerkeses me shkrim ndaj Operatorit, jo me vone se 10 dite kalendarike perpara dates se pezullimit.

5.2.7 Ne cdo rast, pezullimi i sherbimit nuk mund te kerkohet me shume se dy here brenda 12 muajve dhe ne cdo rast koha totale e pezullimit nuk mund te jete me e gjate se 3 muaj.

5.2.8 Periudha e pezullimit ne cdo rast do t'i shtohet afatit te kontrates apo produktit te perfitur nga pajtimtari. Sherbimet e pezulluar do te riaktivizohen automatikisht me mbarimin e periudhes se specifikuar ne kerkesen e pajtimtarit. Tarifa e pezullimit do te percaktohet sipas listes se cmimeve ne fuqi. sherbimit/sherbimeve.

5.2.9 Te mos paguaje ndonje tarife gjate periudhes se pezullimit te sherbimit, pervec asaj te pezullimit te sherbimit, e cila eshte e pagueshme ne momentin e paraqitjes se kerkeses per pezullim sherbimi.

5.2.10 Ne rastin e sherbimeve qe ofrohen se bashku apo per shkak te natyres se tyre jane ngushtesisht te lidhura me njera tjetren, pezullimi i sherbimit nuk do te ofrohet vetem per sherbimet me vehte. Operatori ne çdo rast mund te vendose ne diskrecionin e tij ndryshe.

5.2.11 Te revokoje ne cdo kohe pelqimet paraprake te dhena prej tij me paraqitjen e kerkeses ne nje nga format e parashikuara ne kete kontrate.

5.2.12 Te marre pa pagese fature per sherbimet, si edhe te kete akses ne informacionin online te faturave mujore. Fatura e detajuar permban te paktën informacion lidhur me: numrat dhe llojet e sherbimeve te periudhes raportuese; shumen totale sipas llojeve te sherbimeve; shumen totale te fatures; taksat e aplikuar; shumen e zbritjeve per pajtimtarin; shumen totale perkatese; periudhen e pageses; menytrat e mundshme te pageses, kredencialet e operatorit dhe personat e kontaktit dhe i mundesohet pajtimtarit vetem me kerkese te ketij te fundit pa pagese per periudhen paraardhese.

5.2.13 Ne rastet kur operatorin, nuk ekzekuton brenda afateve te perckatuara ne kete Lidhje, kerkesen e pajtimtarit per nderprerjen e njeanshme te kontrates, kontrata nuk do te konsiderohet e nderprere dhe pajtimtari do te gezoje te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara ne kete Lidhje.

NENI 6 FATURIMI

6.1 Faturimi per Pajtimtarin do te jete me baze mujore dhe do te kryhet sipas percaktimeve kesaj kontrate dhe anekseve te saj.

6.2 Fatura i dorezohet Pajtimtarit ne menyren dhe formen e kerkuar nga pajtimtari, jo me vone se pesembedhjete dite kalendarike perpara afatit te pageses se saj. Per kategorine jo individ, fatura do ti komunikohet Pajtimtarit ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi dhe percaktimeve specifike mbi fiskalizimin.

6.3 Pajtimtari do t'i paguaje operatorit nje çmim, per sherbimet e ofruara, respektivisht:

6.3.1 Çmimin fillestar per akses ne rrjet dhe/ose aktivizimin e sherbimit (kur aplikohen) per te cilin eshte lidhur Kontrata e Pajtimtit. Çmimi do te paguhet brenda afatit sipas kontrates dhe nuk eshte subjekt i kompesimit me perfundimin e kontrates.

6.3.2 Vleren e gjithe sherbimeve te perdorura gjate periudhes se faturuar. Periudha e faturimit zgjat nga dita e pare deri te dita e fundit e muajit kalendarik.

6.3.3 Tarifen e pajtimtit mujor, e cila i takon plotesimit te aksesit per sherbimet e specifikuar per te cilat nje kontrate eshte lidhur.

6.3.4 Çmimin per pajisjen fundore kur blihet nga operatorin ose qerane per perdorimin e pajisjes fundore (kur aplikohen).

6.3.5 Tarifen per asistencë teknike ne perdorimin e sherbimeve, perfshire instalimin, mirembajtjen dhe riparimin e pajisjeve te komunikimeve elektronike te ofruara (kur aplikohen).

6.3.6 Pagesa per te tjera sherbime te specifikuar ne listen e çmimeve te operatorit (kur aplikohen).

6.4 Faturimi per mbipagesen ne rastin e parapagimit do te behet ne faturen e muajit pasardhes.

6.5 Operatori faturon sherbimet e ofruara me parapagim ose paspagim, sipas specifikimeve ne Aneksin perkates te produktit te ofruar.

6.6 Ne faturen e derguar Pajtimtarit, pervec vlerave te detyrimeve, Operatori perfshin:

- Afatin e pageses se fatures;
- Menyren dhe vendin e pageses se fatures;
- Pagesat shtese;
- Sanksionet ne rast moshlyerje te detyrimeve (kamat-vonesat, nderpreje, kufizim te sherbimeve etj.);
- Numer kontaktit te Operatorit per Kujdes ndaj Klientit per informacion per faturen (thirrjet drejt ketij numri jane pa pagese ose me kosto sipas percaktimeve ne aneksin e tarifave perkatesisht).

NENI 7. KRYERJA E PAGESAVE

Detyrimet financiare te Pajtimtarit ndaj Operatorit kryhen si me poshte:

7.1 Per vleren e instalimit, aktivizimit te sherbimit, te pajisjes fundore apo konfigurimit te saj, me LEK ne dore, vetem njehere, prane arkës se Operatorit ose me Urdher-Xhirimi ne emer dhe ne favor te Operatorit, sipas percaktimeve ne faturen e leshuar, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, referuar tarifave te percaktuara ne Aneksin 1.

7.2 Pagesat mujore per sherbimet e marra sipas kontratës.

7.3 Detyrimet sipas pikes 7.2 duhet te shlyhen brenda afatit te percaktuar ne fature dhe ne cdo rast jo me vone se dita e fundit e muajit.

7.4 Mosmarrja e fatures nuk e çliron pajtimtarin nga detyrimi per te paguar brenda kohes se percaktuar.

7.5 Date pagese do te konsiderohet:

a. Data e shenuar ne mandat arketimi, ne rastin kur pagesa kryhet me LEKE ne dore, prane njesise arketimore te Operatorit.

b. Data e prekjes se llogarise bankare likujduese te Operatorit, ne rastin kur pagesa kryhet me Urdher-Xhirimi bankar apo nepermjet sistemit elektronik te pagesave.

NENI 8 SANKSIONET

8.1 Ne rast vonesash ne lidhjen ne rrjet ne afat ose ne aktivizimin e sherbimit, Operatori do te paguaje nje penalitet e masen 0.1% te tarifes fillestare per lidhjen ne rrjet dhe aktivizimin e sherbimit per cdo dite vonese, por jo me shume se 20% te kesaj tarife. Perjashtim nga ky penalitet bejne rastet kur vonesat jane shkaktuar nga veprime apo mosveprime te Pajtimtarit ose paleve te treta, jashte kontrollit te Operatorit.

8.2 Ne rast se sherbimi i kontraktuar nuk ploteson nivelin e cilesise se parashikuar ne kontrate dhe/ose Operatori vonon riparimin e difekteve ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve, tej afateve te percaktuara ne kete Kontrate, atehere ai detyrohet t'i zbrese nga fatura e muajit ne vijim ne tarifen e pajtimit proporcionalisht me ditet ne mungese cilesie/vonese riparimi difekti.

8.3 Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen e fatures sipas afatit te saj, Operatori ka te drejte te ndermarre sanksione dhe masa kufizuese te ofrimit te sherbimit per Pajtimtarin deri ne perfundimin e kontrates:

a. Operatori aplikon per cdo dite vonese nje penalitet ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar dhe brenda 7 diteve pas kalimit te afatit te pageses te percaktuar ne fature, do te njoftoje Pajtimtarin me shkrim ose me SMS/telefonate per permbushjen e detyrimit te pageses dhe/ apo detyrimeve te tjera kontraktore, brenda dates 15 te muajit aktual dhe per kufizimin e ofrimit te sherbimit te telefonise fikse, duke i dhene mundesine pajtimtarit te thirret nga te tjeret (i njeanshem, vetem hyres) dhe te perdore Sherbimet e Emergjences;

b. Operatori, pas 15 ditesh nga kalimi i afatit te pageses te percaktuar ne fature, do te ekzekutoje kufizimin e sherbimit te telefonise fikse duke nderprere ofrimin e sherbimit te thirrjeve dalese per telefonine fikse dhe ne te njejten kohe do te vijohet me njoftimet me sms/ telefonate per masat qe mund te ndermerren ne vijim.

c. Ne rast mos shlyerjes se detyrimeve me plotesimin/kalimin e 30 diteve te afatit te pageses se percaktuar ne fature, sherbimet e kontraktuara do te nderpritet teresisht. Ne cdo rast thirrjet drejt numrave te emergjences do te lejohen.

d. Operatori, gjate muajit te dyte pas afatit te pageses se fatures, gjeneron fature per sherbimet e ofruara gjate muajit te meparshem dhe vijon me njoftimet respektive mbi shlyerjen e detyrimeve edhe per faturen e muajit paraardhes dhe te gjitha detyrimeve kontraktore.

e. Ne muajin e trete pas afatit te rregullt te pageses se fatures, operatori i dergon njoftim me shkrim pajtimtarit per permbushjen e detyrimeve brenda 15 diteve nga data e ketij njoftimi dhe nderprerjen e kontrates ne menyre te njeanshme brenda 3 diteve nga kalimi i afatit 15 ditor te percaktuar ne kete paragraf. Ne rast te moshlyerjes se detyrimeve edhe sipas ketij njoftimi, Operatori do te ekzekutoje te drejten e nderprerjes se kontrates me pajtimtarin.

8.4 Operatori nuk eshte i detyruar te njoftoje paraparakisht Pajtimtarin per masat e marra ne rast se shkelja e evidentuar e kontrates:

- perben nje kercenim serioz te rendit e sigurise publike, shendetit e mjedisit;
- shkakton nje demtim serioz fizik, material ose funksional te rrjetit.

8.5 Nese eshte teknikisht e mundshme, Operatori eshte i detyruar te kufizojte aksesin vetem per ato sherbime qe Pajtimtari ka shkelur kushtet e kontrates, pervec rasteve kur Pajtimtari abuzon, ose ne menyre te perseritur kryen me vonese ose nuk paguan faturat.

8.6 Ne cdo rast, kur Pajtimtari vonon pagesen e vleres se fatures, tej afateve te percaktuara ne fature dhe brenda ketij afati nuk ka bere ankese me shkrim per faturen, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar, per cdo dite vonese ne pagim nga afati i pageses se percaktuar ne fature.

8.7 Ne rast se Pajtimtari ka bere ankese me shkrim per faturen, para afatit te pageses, atehere:

- a. Operatori ka detyrimin te trajtojte ankesen dhe ktheje pergjigje sipas percaktimeve te kesaj kontrate.
- b. Operatori mund te mos aplikojte masat kufizuese te referuara me siper.

8.8 Shuma te mbitarifuar per sherbimet e ofruara dhe shumat e ankimuar sipas parashikimeve te kesaj kontrate Pajtimi do te zbriten nga cmimi i pajtimit mujor per muajin/t tjetere dhe me perfundimin e Kontrates se Pajtimit do t'i paguhen pajtimtarit nepremjet llogarise bankare te njoftuar zyrtarisht, nese kushtet per perfundimin e Kontrates se Pajtimit jane plotesuar.

NENI 9 PERFUNDIMI I NJEANSHEM I KONTRATES

9.1 Operatori ka te drejte te nderprese ofrimin e sherbimit dhe te perfundoje ne menyre te njeanshme kontraten pa njoftim paraprak ndaj pajtimtarit ne rastet si me poshte vijon:

- konstaton kundervajtje flagrante, sistematike apo te vazhdueshme te detyrimeve kontraktuale dhe ose te Termave te Pergjithshme te sherbimit. Ne kuptim te ketij parashikimi me shkelje flagrante dhe shkelje sistematike te detyrimit kontraktual do te kuptohen:

- o "Shkelje flagrante e detyrimit kontraktual" eshte nje shkelje qe shkakton ose mund te shkaktojte dem tek pajtimtare/perdorues te tjere ose tek operatori,
- o "Shkelje sistematike e nje detyrimi kontraktual" eshte nje shkelje qe ka ndodhur dy a me shume here brenda afatit te kontrates.

- pajtimtari me dashje demton/prish ose lejon shkaterrimin/demtimin/thyerjen/e modemit dhe ose pajisjeve te tjera te komunikimeve elektronike te ofruara nga operatori, nese nuk paguan kompensim per cdo dhe te gjitha demet aktuale te shkaktuara ndaj operatorit, perfshire dhe kostot e pajisjes fundore

- sipas parashikimeve te pikes 8.3.e,
- ne rast te forces madhore.

9.2 Pajtimtari ka te drejte ta quaj kete Kontrate te perfunduar ne ditin e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore ne rast se kerkesa per perfundim eshte paraqitur jo me vone se data 25 e muajit.

9.2.1 Ne rast se kërkesa për perfundim paraqitet pas datës 25, kontrata do të konsiderohet e perfunduar në ditën e fundit të muajit pasardhës.

9.3 Pajtimtari ka të drejtë të zgjidhë Kontraten në mënyrë të njëanshme dhe pa kosto shtese, duke e njoftuar me shkrim Operatorin brenda një afati 30 ditor nga data e njoftimit, në rastet e modifikimit/zevendësimit të kontratës nga Operatori.

9.4 Zgjidhja e kontratës nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.

9.5 Pajtimtari ka të drejtë të ndërprejë kontratën në mënyrë të njëanshme me një njoftim me shkrim tek Operatori dhe plotësimin e formularit përkatës dhe kontrata do të konsiderohet e perfunduar sipas parashikimeve në paragrafin 9.2.

9.5.1 Në rast, Pajtimtari është përgjegjës në lidhje me kryerjen e të gjitha pagesave dhe detyrimeve që i perkasin kontratës dhe kthimin e aparateve dhe pajisjeve të komunikimeve elektronike në rast se janë dhënë në përdorim nga Operatori.

9.6 Në rast, Operatori gezon të drejtën të perfundojë këto kontrata në çdo kohë, me një njoftim paraprak 30 ditor drejtuar Pajtimtarit. Perfundimi dhe ndërprerja e një/ disa prej shërbimeve në mënyrë të njëanshme nga palet nuk nënkupton edhe perfundimin në të njëjtin afat të kontratës, me përjashtim të rastit kur me kontratën merret vetëm një shërbim.

NENI 10 RUAJTJA E FSHEHTESISE SE KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE DHE PERDORIMI I TE DHENAVE PERSONALE

10.1 Operatori detyrohet të sigurojë zbatimin e Rregullat në fuqi lidhur me mënyrën e mbledhjes, përpunimit apo transferimit të të dhënave personale të pajtimtarit sipas Ligjit nr. 9887/2008, i ndryshuar dhe akteve të tjera nenligjore në zbatim të tij.

10.2 Operatori nuk do të kontrollojë ose të përhapë të dhënat personale ose përmbajtjen e bisedave të kryera nëpërmjet rrjetit të Operatorit, përveç rastit kur kjo nevojitet si pjesë e veprimtarisë së mirëmbajtjes së rrjetit ose parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

10.3 Operatori nuk do të përhapë, transmetojë ose të përpunojë të dhënat personale të Pajtimtarit, përfshirë (por pa u kufizuar në) të dhënat për shumat e shpenzuara ose për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar të dhënat, përveç rastit kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe ka lidhje të drejtepërdrejte me dhenien e shërbimeve dhe/ose përmbushjen e kesaj Kontrate, si dhe rastit kur një gjë e tillë parashikohet nga legjislacioni në fuqi. Pajtimtari mund të informohet në çdo kohë.

10.4 Operatori do të mbledhë, përpunojë e përhapë të dhënat personale të Pajtimtarit për përmbushjen e kesaj Kontrate. Të dhënat personale si: emër, mbiemër, nr. personal identifikimi, datelindje, gjinia, fotokopje e mjetit të identifikimit dhe adresa e banimit, janë të dhëna të detyrueshme për të bërë të mundur regjistrimin dhe lidhjen tuaj me rrjetin. Të dhënat e tjera të kontaktit janë të dhëna vullnetare për të përfituar nga shërbimet e kujdesit ndaj klientit. Duke nënshkruar këto kontrata, pajtimtari pranon që Operatori të përpunojë dhe përhapë të dhënat e tij për qëllime të kësaj kontrate, ku përfshihen (por nuk kufizohen vetëm me to) përpunimi i kërkesave për pajtim në rrjet, dhënia e shërbimeve dhe produkteve dhe shërbimeve Pajtimtarit, mbajtja e llogarive të transaksioneve, përgatitja e faturave dhe dhënia e shërbimit të kujdesit për klientin (përfshirë dërgimi i faturave nëpërmjet shërbimit postar), kontrolli dhe raportimi i kreditit, krijimi i databazës së debitoreve me detyrime të papaguara dhe mbledhja e detyrimeve kontraktore të papaguara nëpërmjet të treteve për llogari të Operatorit, krijimi dhe matja e bazave të të dhënave dhe platformave të shërbimit, kryerja e analizës e studimeve për informacion biznesi dhe qëllime marketingu, profilizim i pajtimtarit, zhvillim i produkteve dhe shërbimeve, ristrukturimi apo riorganizimi i biznesit të Operatorit, siguria e rrjetit Operatori dhe e informacionit, mbrojtja e aseteve dhe të drejtave të Operatorit, përfshirë të drejtat e pronësive intelektuale dhe marken tregtare, punonjësit dhe klientet nga aktiviteti kriminal apo aktivitet tjetër që mund të shkaktojë dëm, për të mbushur detyrimet ligjore dhe rregullatore në lidhje me procedurat ligjore, përfshirë dhe mbrojtjen në procese ligjore kundër Operatorit si dhe përhapjen e të dhënave të treteve me qëllim mbledhjen e detyrimit të pashlyer në rast se Kontrata me pajtimtarin zgjidhet për këto arsye.

10.5 Operatori ose agjentet e tij mundën që, here pas here, të kontaktojnë pajtimtarin nëpërmjet postes/ telefonit/ e-mail, apo SMS në lidhje me shërbimin e ofruar dhe të pranuar nga pajtimtari (p.sh. për jo kufizuar në: furnizimi i shërbimit të asistencës ose sekretarise telefonike, gjendjen e marrjes së mesazheve ose të pagesave etj.).

10.6 Me pëlqimin paraprak të pajtimtarit, Operatori mund të kontaktojë këto të fundit nëpërmjet postes/ telefonit/e-mail apo SMS në lidhje me detajet e shërbimeve dhe produktet e reja që Operatori ofron. Në rast se pajtimtari vendos të mos marrë me komunikime të kesaj natyre, mund ta kërkojë këto në çdo moment dhe pa pagesë, me kërkesë në dyqanë ose nëpërmjet aplikacioneve që Operatori ka krijuar për Pajtimtarin e tij.

10.7 Operatori merr përparësi të respektojë fshehtësinë dhe privatesinë e Pajtimtarit dhe trajtojë të dhënat personale të Pajtimtarit në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9887, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 54/2024, aktet nenligjore të dala në zbatim të tyre si dhe për qëllimet e lejuara të biznesit.

10.8 Operatori do të ruajë të dhënat personale të pajtimtarit në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe do t'i bejë të vlefshme për pajtimtarin me kërkesën e tij me shkrim, përsa kohë që ende disponohen nga Operatori.

10.9 Të dhënat mbi numrin personal të identifikimit të pajtimtarit mund të përdoren për rigjenerimin e të dhënave nga sipërmarresi në gjykatë.

10.10 Operatori garanton se nuk kryen përgjime të komunikimeve elektronike. Përgjimi i komunikimeve elektronike kryhet vetëm nga organet kompetente shtetërore të përcaktuara në Ligjin Nr. 9157 date 04.12.2013 “Për përgjimin e telekomunikimeve”(i ndryshuar).

10.11 Ne perputhje me parashikimet ligjore, ne lidhje me te dhenat personale qe perpunohen nga Operatori, ju ne cdo kohe keni te drejtat si vijojne:

e drejta per akses, e drejta per te kerkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen, e drejta per te mos qene pjese e vendimarrjeve automatike, e drejta per te kundershuar dhe e drejta per tu ankuar.

10.12 Operatori brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses do ju dergoj informacionin e kerkuar ose arsyen e mosdhenies ose mosekzekutimit te kerkeses tuaj. Ne cdo rast per ekzekutimin e kerkesave Operatori mund te kerkoje informacion shtese per identifikimin e sakte tuaj per te shmangur qe informacioni juaj te perhapet tek persona te paautorizuar.

NENI 11 KUSHTE TE PERGJITHSHME

11.1 Kjo Kontrate hartohet dhe interpretohet nga Palet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore te Republikes se Shqiperise.

11.2 Mosmarveshjet qe lindin ndermjet paleve zgjidhen sipas percaktimeve ne Udhezuesin e Mosmarveshjeve me pajtimtarin te dhena si Aneks i kesaj Kontrate. Ne rast se palet nuk arrijne te zgjidhin mosmarveshjen me mirekuptim, secila mund t'i drejtohet per shqyrtim AKEP, ose Gjykates kompetente.

11.3 Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne ditën e nenshkrimimit te saj nga palet.

11.4 Ne rast perfundimi te Kontrates per shkak te mosshlyerjes se detyrimeve nga ana e Pajtimtarit, si personalisht, apo si person juridik do te humbase te drejten te lidhe nje kontrate tjeter me Operatorin pa shlyer me pare detyrimet e tij te prapambetura ndaj Operatorit. Operatori do te ruaje te drejten e tij per te kerkuar sipas ligjit pagimin e detyrimeve te pashlyera.

11.5 Ndryshimet e Termave te Pergjithshme te Kontrates mund te aplikohen vetem pas njoftimit perkates te tyre tek AKEP.

ANEKSI 1

AKSESI - PLANI TARIFOR - ANKESAT

1. Shpejtesia e lidhjes ne internet:

Shpejtesia minimale e lidhjes ne internet _____ Mbps download dhe _____ Mbps upload

Shpejtesia mesatare e lidhjes ne internet _____ Mbps download dhe _____ Mbps upload

Shpejtesia maksimale e lidhjes ne internet _____ Mbps download dhe _____ Mbps upload

2. Plani tarifar:

Tarifa mujore e shërbimit Internet: _____ Lek

Tarifa te tjera: _____ Lek

Tipi/marka e pajisjes se dhene abonentit per përdorim: _____

Numri MAC i pajisjes: _____

IP: _____

3. Kushte te vecanta:

4. Udhezues per zgjidhjen e ankesave

- 1- Ankesat mund te paraqiten :
 - a- Nepermjet numrit _____ per “Difekte dhe asistence teknike”, ose aplikacione komunikimesh qe operojnë me kete numer.
 - b- Nepermjet sporteleve Operatori ku merret deklarim shkresor per ankesen.
 - c- Nepermjet postes per ankesa te ndryshme.
 - d- Me e-mail ne adresen _____.
- 2- Pajtimtaret kane te drejte te ankohen apo te kerkojne sqarime tek operatori qe ofron sherbime te komunikimeve elektronike per kushtet kontraktore dhe/ose permbushjen e ketyre kushteve nga operatori, perfshire faturen dhe cilesine e sherbimit te ofruar.
- 3- Afati i paraqitjes se ankesave me shkrim, nese pajtimtari nuk ka ngelur i kenaqur me sqarimet e dhena nga operatori nepermjet telefonit apo njoftimeve te tjera me mjetet elektronike, eshte:
 - a- Ankesat per “Difekte Teknike” dhe “Asistence teknike per sherbimin e aksesit ne internet” paraqiten ne cdo kohe (sherbimi 24 oresh)
 - b- Ankesat per faturim paraqiten brenda 15 diteve nga marrja e fatures
 - c- Ankesa per cilesine e sherbimit e ofruar, brenda 15 diteve nga ofrimi i sherbimit.
 - d- Ankesa per mos riparim te difekteve te paraqiten menjehere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.
 - e- Ankesat e tjera, te cdo lloji qofshin paraqiten sa me pare.
- 4- Ankesat , ne varesi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatese e Operatorit, mbeshetur ne te dhenat e marra nga Deget apo Sektoret e tjere dhe konforme rregullave behet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara ne Kontraten e Pajtimtimit.
- 5- Afati i nformimit me shkrim te Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit te ankesave eshte brenda 15 diteve kalendarike nga marrja e tyre.
- 6- Pergjigja per ankesen i dergohet pajtimtarit nepermjet menyrave te komunikimit si me poshte vijon:
 - Poste; SMS; Telefonate; adrese elektronike (email);
- 7- Nese pajtimtari nuk eshte i kenaqur me pergjigjen e dhene nga Operatori, pajtimtari mund te kerkoje nga AKEP-i te zgjidhe mosmarreveshjen me Operatori, ose te ndjeke kerkesen ne rruge gjyqesore. Kerkesa e pajtimtarit, per zgjidhje mosmarreveshje ne AKEP, paraqitet me shkrim dhe duhet te permbaje fakte dhe prova, ne te cilat eshte bazuar. Kerkesa duhet te paraqitet ne AKEP brenda 15 diteve pasi pajtimtari te kete marre pergjigjen me shkrim nga Operatori.
- 8- Operatori mban nje rregjister te vecante per ankesat e paraqitura dhe pergjigjet apo vendimet respektive sipas kushteve te kontrates.